

Grafiku pasues është modifikuom prej Quirk, et al. 247.

Emënat	të përgjithëshëm	të numrueshëm	konkret	gur, libër
			abstrakt	vështirësi, vërejtje
	të panumrueshëm	konkret	mjaltë, arenc (en. steel)	
		abstrakt	muzikë, matematikë	
	të përveçëm	Fred, Frida		

3.6.2 Gjinia

Gjinia e emënave tregohet më qartazi në emënoren e shquome dhe të pashquome, njëjës. Por, disa emëna, kur kalojnë në shumës, ndërrojnë gjiní.

Sostorja -ë nuk tregon gjininë në çdo herë, p.sh., *djalë-i, kalë-i*; por edhe, *hanë-a, lamë-a*

1. Mbaresa tipike femnore e trajtës së pashquome është **-e** e patheksuome, si në *File*, *Shtojzovalle*. Por, një shumicë emënash femënorë sosin më **-ë**, si në *Zanë, Orë*, ose më zanore të tjera, si në, *drejtorí, vllazní, shtëpi, anije*, e të tjerë.

1.1. Në trajtën e shquome, mbaresa tipike femënore është **-a**.

Shtojzovalle-ja, Zanë-a, Orë-a, Lulë-a, Prennë-a, Margjelë-a, Vidë-a, Dhorë-a, Perendi-a, lajthi-a, foto-ja, drejtori-a, vllazni-a, anije-a, shtëpi-a,

Kjo nuk është mënyra si gegët i artikulojnë këto fjalë, por norma insiston në këto forma: *lule-luleja, Dranne-Draneja, Çeçile-Çeçileja, File-Fileja, Hatixbe-Hatixheja.*

Por, *anije-anija, hije-hija.*

1.2. Në emënimin e profesioneve, mbaresa tipike femënore është **-e**, si në, mësues, mësues**e**; shkruer, shkrues**e**.

1.3. Prejse mbaresa -a ka thëjë femnore, disa emëna të seksit mashkullor, tingëllojnë sikur të ishin femënorë.

Gjikë-a, Gjekë-a, Haxhi-a (tosk. Haxhi-u), Koço-ja, Gjeto-ja, Sulo-ja (geg. Sul-a), Zylo-ja, Meke-ja, Dyllo-ja, Balo-ja, Kuqo-ja, Murro-ja.

2. Emënat tipikë mashkullorë sosin më një rrokje të shkurtë të mbyllun, që mund të jetë e theksuome si në *kush' trim*, ose e patheksuome, si në '*mashkull*. Kur shquhen, këta emëna marrin kryesisht -i, por edhe -u, si në:

Zot-i, dash-i, çap-i, mal-i, kusht-i, kushtrim-i, mashkull-i, breg-u, mik-u

2.1 Prejse shquomja me -i, ose -u ka lidhje të ngushtë me gjininë mashkullore, emënat e femnave si *Lumi, Luçi, Vali* tingëllojnë mashkullorë.

2.2. Ka edhe emëna mashkullorë që sosin më zanore të plota si *Dritëro-i*, ose togzanorë, si *ftua-i/ni*.

3.6.3 Numëri

Emenat e gjuhës shqipe dalin në njëjës dhe shumës, si në: *një djalë, disa djem*. Kalimi në shumës quhet dallimi në mes të trajtës së pashquome njëjës dhe trajtës së pashquome shumës, si në: *një qytet – disa qytet* (dhe qyteti – qytetet). Ndërrimet *qytet-qyteti*, dhe *qytete-qytetet* quhen shquomje.

shumësi: *qytet – qytet*

shquomja: *qytet – qytet; qytete – qytetet*

Konceptet kryesore që ndihmojnë të kuptuomit e formimit të shumësit përfshijnë: a) *pa ndërrim*, b) *me ndërrime sostore*, c) *me shtime sostore*, c) *me ndërrime në rranjë*.

Shenim: Prapashtesat nuk kanë lidhje me formimin e shumësit.

a. **pa ndërrim:** Këtu hyjnë emënat që dalin në të njëjtën formë në njëjës të pashquom dhe shumës të pashquom, si në: *një liri, disa liri*

b. **ndërrime sostore:** Gjuhtarët besojnë se një *i në sosjet e shumësit ka qiellëzua pëlçitëset /k, g/ dhe langëzoret /r, ll/ (Camaj, AG 23).

mik-q; fik-q, peshk-q, ujk-q, zog-gj, akull-j, kërmill-j, kapruall-oj; çakall-j, popull-j, hell-j, hyll-j, bir-j, lepur-j, flamur-j.

fik, fig; mik, miq; kungull, kunguj; lepur, lepuj

c. **shtesat sostore:** Shumësi mund të formohet edhe duke shtua tinguj në fund të fjalës.

motër, motër; vëlla, vëllazen; ujë, ujëna

ç. **ndërrime në rranjë** nënkuptojnë ndërrimin e zanoreve brenda rranjës. Në fonologji ky process i brendëshem i gjuhës shqipe quhet metafoní.

dash, desh; mezat, mezetën; breg, brigje.

d. Shumësi mund të formohet me një prej processeve ose me kombinim të dy a më shumë proceseve, si në:

mezat – mezeten.

dh. Formimi i shumësit, si aspektet tjera të gjuhës, nuk është shkencë egzakthe, prandaj të folme të ndryshme mund të zgjedhin rava të ndryshme. Për shembull, mund të dëgjohen: *gjt, gini, giu; ginjte, gite, giri*. Po ashtu, *një qen, disa qen(ë); një qen, disa qej*

Ka herë edhe kur fjalët dalin afërsisht të njëjta, prandaj, folësit mund t'i shkrijnë ato. Një shembull i tillë është *gjt > ginj*t (pjesë trupë); dhe *gjt > ginet* (shenjim gjeografik). Por dallimi është i nevojshëm,

Ginet e Adriatikut. Ginjte e gruas.

3.6.4 Shquomja

Treguesit gramatikorë të shquomjes dalin në njëjës dhe në shumës. Hapi i parë në këtë drejtim është dallimi i treguesve të shquomjes prej atyne të shumësit.

Numëri	Njëjës		Shumës	
	një djalë		disa djem	
Trajta	E pashquome	E shquome	E pashquome	E shquome
	një djalë	djal <u>i</u>	disa djem	djem <u>të</u>

Mund të thohet: *njëjës i shquom, i pashquom* ose *shumës i shquom, i pashquom*, por, zakonisht, kur flitet për njëjës dhe shumës, merren parasysh trajtat e pashquome.

Treguesit gramatikorë të shquomjes së numërit njëjës përkojnë me treguesit gramatikorë të gjinive mashkullore dhe femënore: **a, i, u**, si në: *nana, djali, miku*. Treguesit gramatikorë të shquomjes së emënavë të lashtë asnjëanës janë **-të, (ë)t, -t**, si në: *mish-të, ujët, krye-t*.

3.6.5 Ramjet (en. cases)

Ndryshimi i emënit gjatë kalimit nëpër ramje qubet lakim. Të gjithë emënat e gjuhës shqipe lakohen. Por, disa ramje janë shkruar me njëna-tjetren, prandaj, emënat nuk ndryshojnë sa herë që ndryshojnë ramjet. Ky fenomen vërehet në pëndsimin e emënore me kallzoren e thirroren, dhe të dhanores me rrjedhoren.

Kur ramjet marrin parafralë, këto të fundit dhe lokucionet janë specifike; domethanë, parafralët përkojnë me një ramje të caktuome. Këtij rregulli i shmangen vetëm parafralë si ‘*ndaj, për*’ dhe lokucione si ‘*me anë*’.

Gjinore (mjetsore): E rregulloi punën **me anë** të disa miqëve.

Rrjedhore (mjetsore): E rregulloi punën **me anë** miqësh.

Rrjedhore (kufizuese): Vuajtja i kishte bënë më të ndjeshëm **ndaj** së keqes.

Kallzore (kohore): **Ndaj** të ngrysun ata ndezën dritat.

Kallzore (qëllim): Këto janë **për** librarinë.

Rrjedhore (pjesë e tansisë): E tërhoqi **për dore(t)**.

Me lehtësia të kuptuomit e ramjeve, rishtarët mund të shtojnë numrorin ‘një’ para ramjes së trajtës së pashquome njëjës, dhe ‘disa’ para ramjes së pashquome shumës.

Njëjësi i pashquom:

Emnore: Një libër ishte në tavolinë.

Gjinore: Libri ishte i një vajze.

Dhanore, pastaj kallzore: Mësuesi i dha një vajze një libër.

Kallzore, pastaj dhanore: Mësuesi i dha një libër një vajze.

Rrjedhore: Vajza mori një libër prej një mësuesi.

Shumësi i pashquom:

Emnore: Disa libra ishin në tavolinë.

Gjinore: Librat ishin të disa vajzave.

Dhanore, pastaj kallzore: Mësuesi u dha disa vajzave disa libra.

Kallzore, pastaj dhanore: Mësuesi u dha disa libra disa vajzave.

Rrjedhore: Vajzat moren disa libra prej disa mësuesve.

Gjuhtarë i rendisin ramjet në mënyra të larmishme. Kështu, renditja e ramjeve prej gjuhtarëve amerikanë përkon me renditjen e ramjeve në shqipen, kurse renditja e ramjeve prej gjuhtarëve anglezë përkon me zgjedhjen e bame në këtë tekst. Sipas metodës së dytë, ramjet kanë hierarki natyrore. Kështu, kur një ramje mungon, edhe ramjet që renditen nën të mungojnë.

Renditësi pasuas tregon ramjet, parafralët kryesore që përkojnë me çdo, dhe shemuj në njëjësin e pashquom dhe të shquom.

Shenim: ramjet dalin edhe pa parafralë.

Shkurt.	Ramjet	Parafralët	Shembuj
EMN.	Emnore	<i>te/ tek; nga/ kah; me thejë kah</i>	te fto-i, tek ura
THIRR	Thirre	<i>o, moj, mor, more, or, ore</i>	o ftua
KALL.	Kallzore	<i>mbë, mbi, me, ndaj, ndër më, në, nëpër, nën, pa, për, bashkë me, vetëm me, sëbashku me, me gjithë, në lidhje me, në kundërshtim me, në përjasje me, në krahasim me, në përputhje me, në mospërjasje me, në kontrast me</i>	<i>mbë fto-in e butë; nëpër dromin e lashtë; në kundërshtim me idetë e pashave osmanli</i>
GJIN.	Gjinore	<i>me anë, me anën, në drejtim, për bir, në vend, për arsye, për shkak</i>	me anë të çelës-it
DHAN.	Dhanore	-	ftoi-t; ftonit

VEN.	Vendore	mbë, ndë	mbë ftua
RRJE.	Rrjedhore	<i>afër, buzë, larg, majë, me anë, midis, ndaj, ndër, në mes, në skaj, para, pas, për, përtej, pranë, prej, rranzë, sipas, sipër</i>	<i>prej fto-it; prej ftonit</i>
INS.	Instrument.		

Disa vërejtje

1. Radhitësi i masipërm tregon se hierarkia e ramjeve nuk është shkencë egzaktesepse ndërsa shqipes i mungon ramja vendore, ajo ka ramjen që vjen pas saj, rrjedhoren. Megjithatë, disa argumentojnë se vendorja është shkrimë me ramjet tjera.

2. Ramja thirrore mund të shkrihet krejt lehtë me emënoren e pashquome, megjithatë, kur pendsohet emëni me mbiemënin e familjes, emëni e humbë gjatsinë e rrokjes sostore, p.sh., *Gjik Maliqi; jo Gjike Maliqi*. Kështu, ramja gjinore nuk mund ta përfshijë ramjen thirrore në të tana përdorimet.

3. Ramja dhanore nuk ka parafjalë.

4. Parafjala ‘nga’ është sinonime e parafjalës ‘kah’, jo e parafjalës ‘prej’. (Shih Topallin, Çabejn)

5. Parafjala ‘prej’ nuk ka parafjalë sinonime

6. Parafjala ‘tek’ vendoset para emënash që nisin më zanore (tek ura)

7. Parafjala ‘te’ vendoset para emënash që nisin më bashktingëllore (te shtëpia).

3.6.6 Lakimi

Gjuha shqipe ka disa lakime. Më poshtë jepet vetëm një shembull sish.

	Njëjës		-	Shumës	
	- eShq.	+ eShq.		- eShq.	+ eShq.
<i>Emn.</i>	<i>një</i> bé	be- ja		<i>disa</i> bé	be- të
<i>Kall.</i>		be- në			
<i>Gjin.</i>	<i>e një</i> be- je	be- së		<i>e disa</i> be- ve	be- ve(t)
<i>Dhan.</i>	<i>një</i> be- je			<i>disa</i> be- ve	
<i>Rrje.</i>	<i>prej një</i> be- je			<i>prej disa</i> be- sh	

Tipikisht, trajtat e rrjedhores së shumës që sosin më -sh, nuk marrin shva sostore, por kjo nuk përkon me sistemin fonetik të shqipes veri-prendimore. Sikur t’a marrin shvanë (ë) si treguese se rrokja para saj përmban një zanore me duresë të gjatë ose të mesëme, atbotë ortografia do të ndërronte në ‘*prej disa grashë, prej disa beshë*’.

3.3.3 Përemëni

Përemën quhet ajo pjesë e ligiratës që, kryesisht, mos me përsëritë emënin, vëhet në vend të tij.

3.8.1 Farët

Kategoritë kryesore përfshijnë përemënat,

vetorë: *un, ti, etj.*

vetvetorë: *veten, vetja, vetes, etj.*

dëftorë:

afër: *ky kjo*, etj.
 larg: *ai ajo*, etj.
 pronorë: *yt, jote*, etj.
 pyetës: *kush, cili*, etj.
 lidhorë: *që, i cili*, etj.
 të pacaktuom: *dikush, të gjithë*, etj.

3.8.2 Funksionet

Përemënat mund të jenë *tregues, shoqnues, referues, përfaqësues*, dhe *pezullues*.

Funksioni Tregues

Funksioni tregues është tipike e dy vetave të para të përemënave, njëjës e shumës, në disa përemëna pyetës dhe disa përemëna të pacaktuom.

Vetor: Të kërkoj **ajo** vajza e gjatë.
 Pyetës: **Kush** është ajo?
 i Pacaktuom: **Dikush** po troket në derë.

Funksioni Shoqnues

Disa përmëna shoqnojnë emënat që ata përcaktojnë; emënat të cilëve ata u përshkruajn veçsi ose tipare. Këtu përfshihen emënat *dëftorë, pronorë, pyetës*, dhe të *pacaktuom*.

Dëftorë: Pas **këtyre** *ndërtesave* gjindet shtëpia ime.
 Pronorë: Në dalje të *lagjes* **së** *tij* fillon pylli.
 Pyetës: **Cila** *kanë* ju pëlqen më shumë?
 të Pacaktuom: Nuk kam takuom **asnjë** *nxënë* të ri

Funksioni Pezullues

Kur përemënat dëftorë, por edhe të tjerë, nuk e qartësojnë referencën, ata kanë efekt pezullues (en. suspensive).

Pyetje: **Kë** do të takojmë sonte?
 Përgjigje: **Atë** që do t'a njohësh kur t'a shohësh.

Funksioni Absolut

Veçsisht përemënat vetorë, pyetës, dhe të pacaktuom mund të përdoren në mënyrë të pavarun; pa iu referua ndonjë emëni ose fraze.

Vetorë: **Ne** kemi një qëllim.
 Pyetës: **Cilën** more?